



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*

---

**PROJEKTLIGJI PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**THE DRAFT LAW ON THE GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF KOSOVO**

**NACRT ZAKON O VLADI REPUBLIKE KOSOVA**



<p style="text-align: center;"><b>KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS</b></p> <p>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton</p> <p style="text-align: center;"><b>LIGJIN PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 1 Fushëveprimi i Ligjit</b></p> <p>1. Me këtë ligj përcaktohen:</p> <p>1.1. organizimi dhe funksionimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Qeveria);</p> <p>1.2. mënyra e punës dhe procedurat e vendimmarrjes në Qeveri, dhe</p> <p>1.3. bashkëpunimi ndërmjet Qeverisë</p>	<p style="text-align: center;"><b>ASSEMBLY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO</b></p> <p>Pursuant to article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Approves</p> <p style="text-align: center;"><b>LAW ON THE GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF KOSOVO</b></p> <p style="text-align: center;"><b>I. GENERAL PROVISIONS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Section 1 Scope of the Law</b></p> <p>1. The present law determines:</p> <p>1.1. The organization and functioning of the Government of the Republic of Kosovo (herein after “The Government”),</p> <p>1.2. The work method and decision making procedures of the Government, and</p> <p>1.3. The cooperation between the</p>	<p style="text-align: center;"><b>SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA</b></p> <p>Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosova,</p> <p>Usvaja</p> <p style="text-align: center;"><b>ZAKON O VLADI REPUBLIKE KOSOVA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>I. OPŠTE ODREDBE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 1 Delokrug Zakona</b></p> <p>1. Ovaj Zakon određuje:</p> <p>1.1. Organizovanje i funkcionisanje Vlade Republike Kosova (u daljem tekstu: Vlada);</p> <p>1.2. Način rada i postupci donošenja odluka u Vladi, kao i</p> <p>1.3. Saradnja između Vlade i ostalih</p>
--	--	---



dhe institucioneve të tjera të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta).

## **Neni 2 Parimet udhëheqëse**

1. Qeveria është person juridik publik, që ushtron pushtetin ekzekutiv dhe udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

1.1. **Ligjshmëria** – Qeveria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me Kushtetutën, marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat aderon Republika e Kosovës, dhe me ligjet dhe aktet nënligjore të Republikës së Kosovës;

1.2. **Përgjegjshmëria**- e anëtarëve/eve të Qeverisë para Kuvendit të Republikës së Kosovës për veprimet e ndërmarra;

1.3. **Transparenca**- në punën e Qeverisë, si dhe

1.4. **Efikasiteti dhe efektshmëria** në zbatimin e përgjegjësive qeveritare.

Government and other institutions provided for in the Constitution of the Republic of Kosovo (herein after “The Constitution “).

## **Section 2 Guiding Principles**

1. The Government is a legal public person that exercises the executive power and is guided by the following principles:

1.1 **Legality** – the Government performs its duties in accordance with the Constitution, international agreements which the Republic of Kosovo is a part of, and other applicable laws and sub normative acts of the Republic of Kosovo.

1.2 **Responsibility** – the responsibility of members of the Government before the Assembly of the Republic of Kosovo for actions taken;

1.3 **Transparency** – in the work of the Government; and

1.4 **Efficiency and effectiveness** in the fulfillment of Government

institucija određene Ustavom Republike Kosova (u daljem tekstu: Ustav).

## **Član 2 Rukovodeći principi**

1. Vlada je pravno i javno lice, koja vodi ekzekutivu i rukovodise od narednih načela:

1.1. **Zakornost** – Vlada obavlja svoju aktivnost u skladu sa Ustavom, međunarodnim sporazumom koju pristupi Republika Kosov, zakonske i podzakonske akte Republike Kosova;

1.2 **Odgovornost**- članova Vlade pred Skupštinom Republike Kosova o preduzetim radnjama;

1.3. **Transparentnost**- u radu Vlade kao i

1.4. **Efikasnost, efektivnost** u sprovođenju vladinih odgovornosti.



## II. PËRBËRJA, MANDATI

### Neni 3 Përbërja e Qeverisë

1. Qeveria përbëhet nga:
  - 1.1. Kryeministri/ja;
  - 1.2. një apo më shumë zëvendëskryeministra/e;
  - 1.3. ministrat/et dhe
  - 1.4. deri në dy ministra/e pa portofol.
2. Posti i zëvendëskryeministrit/es mund të mbahet nga një ministër/e me portofol, përveç detyrave të tij/saj të zakonshme.
3. Të paktën një (1) nga ministrat duhet të jetë nga komuniteti serb i Kosovës dhe një (1) ministër nga ndonjë komunitet tjetër joshumicë në Kosovë. Nëse janë më shumë se dymbëdhjetë ministra, duhet të jetë edhe një (1) ministër i tretë që përfaqëson një nga komunitetet joshumicë të Kosovës.
4. Të paktën dy (2) nga zëvendësministrat duhet të jetë nga komuniteti serb i Kosovës dhe dy (2) nga zëvendësministrat nga ndonjë komunitet tjetër joshumicë në Kosovë. Nëse janë më shumë se

responsibilities.  
**II. COMPOSITION AND MANDATE**

### Section 3 Composition of the Government

1. The Government is comprised of the:
  - 1.1 Prime Minister;
  - 1.2 one or more deputy prime ministers;
  - 1.3 Ministers; and
  - 1.4 up to two ministers without portfolio.
2. The post of Deputy Prime Minister may be held by a minister with portfolio, in addition to his/her other duties.
3. At least one (1) minister must come from the Kosovo Serb community and (1) minister from another non-majority community in Kosovo. If there are more than twelve ministers, there must be another (1) minister representing the non-majority communities in Kosovo.
4. At least two (2) deputy ministers shall be from the Kosovo Serb community and two (2) deputy Ministers from any other non-majority community in Kosovo. If there are more than twelve (12) ministers, there shall

## II. SASTAV, MANDAT

### Član 3 Sastav Vlade

1. Vlada je sastavljena od:
  - 1.1 Premijera;
  - 1.2 jedan ili više zamenika premijera;
  - 1.3 Ministara i
  - 1.4 do dva ministra/ke bez portfelja.
2. Pozicija zamenika premijera može se voditi od jednog ministra sa portfeljom, osim njegovih uobičajenih zadataka.
3. Najmanje jedan od ministara treba biti od srbskog komuniteta Kosova. Ako su više od 12 ministara treba biti i treći ministar koji predstavlja komunitet manjine u Kosovo.
4. Najmanje 2 od zamenika ministara treba biti izabrani od srbskog komuniteta u kosovo i dva treba da budu sa komuniteta ne većine u kosovo ako su više nego 12 ministara treba biti još treći zamenik



dymbëdhjetë (12) ministra, duhet të jetë edhe një zëvendësministër i tretë, i cili përfaqëson një komunitet tjetër joshumicë të Kosovës.

5. Zgjedhja e ministrave dhe zëvendësministrave, të përcaktuar në paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni, do të vendoset pas konsultimit me partitë, me koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë.

**Neni 4**  
**Zgjedhja e anëtarëve/eve të Qeverisë**

1. Anëtarë/e të Qeverisë mund të zgjidhen:
  - 1.1. shtetasit/et e Republikës së Kosovës të moshës madhore;
  - 1.2. personat të cilët nuk janë shpallur fajtorë për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës;
  - 1.3. personat të cilëve me anë të vendimit të gjykatës nuk iu është hequr e drejta për t'u zgjedhur.

be a third deputy minister, who represents another non-majority community in Kosovo.

5. The selection of ministers and deputy ministers, as set out in paragraph 3 and 4 of this Article, shall be conducted after consultation with the parties, coalitions or groups representing non-majority communities in Kosovo.

**Section 4**  
**Election of Members of Government**

1. The following may be elected as members of the Government:
  - 1.1. Adult citizens of the Republic of Kosovo;
  - 1.2. Persons that have not been found guilty for a criminal act through a final decision of the court;
  - 1.3. Persons whose right of eligibility has not been removed with a court decision.

ministra koji predstavljaju jedan komunitet ne većine u Kosovo.

5. Izbor ministara i zamenika ministara određenih u stavu 3 i 4 istoga člana ima da se izabere nakon konsultacije sa strankom i koaliciju, grupe koje predstavljaju komunitete koji nisu većina u Kosovo.

**Član 4**  
**Izbor članova Vlade**

1. Za članove Vlade mogu se birati:
  - 1.1. Državljeni Republike Kosova koji su punoletni;
  - 1.2. lica koja nisu proglašena krivim za krivično delo konačnom odlukom suda;
  - 1.3. lica kojima sudskom odlukom nije ukinuto pravo biranja.



<p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b> <b>Fillimi i mandatit</b></p> <p>Anëtarët/et e Qeverisë fillojnë mandatin pasi të kenë bërë betimin para Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kuvendi), duke lexuar tekstin në vijim:</p> <p><i>“Solemnisht betohem se do ta kryej me përkushtim dhe nder detyrën e anëtar/it,-es të Qeverisë, do të respektoj Kushtetutën, ligjet dhe rendin juridik dhe do të angazhohem për përparimin e përgjithshëm të Republikës së Kosovës.”</i></p>	<p style="text-align: center;"><b>Section 5</b> <b>Beginning of Mandate</b></p> <p>The members of the Government shall begin their mandate after taking an oath before the Assembly of the Republic of Kosovo (herein after “The Assembly”), by reading the following text:</p> <p><i>“I solemnly swear that I will faithfully and honorably execute my duties as a member of the Government, respect the Constitution, laws and legal order and shall work for the general advancement of the Republic of Kosovo”</i></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 5</b> <b>Početak mandata</b></p> <p>Članovi Vlade započinju svoj mandat nakon davanja zakletve u Skupštini Republike Kosova (u daljem tekstu: Skupština), čitanjem sledećeg teksta:</p> <p><i>“Svećano zaklinjem da ću vjerno i časno izvršavati moje dužnosti kao član Vlade, da ću poštovati Ustav, zakone i pravni poredak i da ću se angažovati za opšti napredak Republike Kosova.”</i></p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Përfundimi i mandatit të Qeverisë</b></p> <p>1. Mandati i Qeverisë përfundon:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>1.1. pas mbarimit të mandatit të Qeverisë;</li><li>1.2. me rastin e votimit të mocionit të mosbesimit;</li><li>1.3. me dorëheqjen e Kryeministrit/es, dhe</li></ul>	<p style="text-align: center;"><b>Section 6</b> <b>End of Mandate of the Government</b></p> <p>1. The mandate of the Government shall end:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>1.1 after the expiration of the mandate of the Government;</li><li>1.2 in case of a vote of non confidence;</li><li>1.3 resignation of the Prime Minister; and</li></ul>	<p style="text-align: center;"><b>Član 6</b> <b>Završetak mandata Vlade</b></p> <p>1. Mandat Vlade se završava:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>1.1. nakon isteka mandata;</li><li>1.2. prilikom izglasanog nepoverenja;</li><li>1.3. ostavke Premijera;</li></ul>



1.4. në çdo rast tjetër, në të cilin posti i Kryeministrit/es mbetet i zbrazët.

**Neni 7**  
**Përfundimi i mandatit të anëtarëve/eve të Qeverisë**

1. Mandati i anëtarëve/eve të Qeverisë përfundon:

1.1. pas pranimit të dorëheqjes nga Kryeministri/ja;

1.2. pas shkarkimit nga Kryeministri/ja;

1.2. në rast të shkarkimit pas votimit të mocionit të mosbesimit;

1.4. në çdo rast tjetër, në të cilin posti i anëtarit/es të Qeverisë mbetet i zbrazët.

**Neni 8**  
**Qeveria në largim**

1. Qeveria në largim nënkupton Qeverinë, e cila shërben gjatë periudhës së shpërbërjes së Kuvendit me qëllim të mbajtjes së zgjedhjeve dhe deri në formimin e Qeverisë së re pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve.

1.4 in any other case the post of the Prime Minister becomes vacant.

**Section 7**  
**End of Mandate of members of the Government**

1. The mandate of members of the Government shall end:

1.1 after the acceptance of their resignation by the Prime Minister;

1.2 dismissal by the Prime Minister;

1.3 in case of dismissal following a vote of non confidence;

1.4 in any other case the post of the Government member becomes vacant.

**Section 8**  
**Government in leaving**

1. A Government in leaving means the Government that operates in the interim period between the normal dissolution of the Assembly for the purpose of holding an election and the formation of the new government after the election results are

1.4. u svakom drugom slučaju, u kom pozicija Premijera ostane upražnjena.

**Član 7**  
**Završetak mandata članova Vlade**

1. Mandat članova Vlade se završava:

1.1. nakon usvajanja ostavke od strane Premijera /ke; o;

1.2. nakon razrešenja od strane Premijera;

1.3. razrešenjem nakon prihvatanja izglasanog nepoverenja;

1.4. u svakom drugom slučaju, kada pozicija ministra ostane upražnjena.

**Član 8**  
**Vlada u ostavci**

1. Vlada u ostavci podrazumeva Vladu, koja služi tokom perioda raspuštanja Skupštine sa ciljem održavanja izbora do formiranja nove Vlade nakon objavljivanja rezultata izbora.



<p>2. Anëtarët/et e Qeverisë janë të detyruar të qëndrojnë në detyrë deri në formimin e Qeverisë pasardhëse.</p> <p>3. Qeveria në largim konsiderohet edhe kur Qeveria bie pas një vendimi të mocionit të mosbesimit ose në rastet kur shpërbëhet Kuvendi.</p> <p>4. Pas pranimit të dorëheqjes së një ministri/e, Kryeministri/ja mund të kërkojë nga ai që të vazhdojë ushtrimin e detyrave deri në emërimin e një ministri/e të ri/e.</p> <p>5. Qeveria në largim kryen vetëm punët e rregullta dhe nuk mund t'i paraqesë Kuvendit projektligje apo të nxjerrë akte të përgjithshme përveç nëse kjo është e lidhur me ndonjë afat ligjor apo kërkesat e shtetit në interes të mbrojtjes apo në rastet e fatkeqësive natyrore apo Gjendjes së Jashtëzakonshme.</p> <p>6. Qeveria në largim nuk mund të emërojë apo shkarkojë persona që janë brenda kompetencave të Qeverisë, përveq ushtruesve të detyrës me rastin e mbetjes së një posti për arsye të dorëheqjes apo shkëljes së detyrës së punës.</p>	<p>known.</p> <p>2. The members of the Government shall continue to perform their duties until the formation of the successor Government.</p> <p>3. The Government is also considered a Government in leaving when it is defeated following a decision for a motion of no confidence or in the case when the Assembly is dissolved.</p> <p>4. After accepting a resignation of a minister, the Prime Minister may request the concerned minister to continue to exercise his/her duties until appointment of a new minister.</p> <p>5. The Government in leaving shall only carry out its regular activities and shall not submit to the Assembly draft laws or issue other general acts, unless it relates to a legal deadline or state needs in the interest of defense, natural disasters or a State of Emergency.</p> <p>6. Government in leaving can not shall not appoint or dismiss persons who are within its competence, except for acting positions in case a post remains vacant due to resignation or breach of duties.</p>	<p>2. Članovi Vlade su obavezni da ostanu na dužnosti do formiranja buduće Vlade.</p> <p>3. Vlada u ostavci smatra se i kada se Vladi izglasa nepoverenje ili u slučajevima kada se raspušta institucija koja odgovara Vladi.</p> <p>4. Nakon prihvatanja ostavke jednog ministra, Premijer može da zatraži od njega da radi na sprovođenju zadataka do naimenovanja novog ministra.</p> <p>5. Vlada u ostavku obavlja samo redovne poslove i ne može da predstavlja Skupštini Nacrtzakone ili da donese opšti akat osim ako ovo je vezano sa zakonskim rokom ili državnim zahtevima u interesu zaštite ili u prirodnih nepogoda ili u vanredno stanje.</p> <p>6. Vlada u ostavki ne može imenovati ili razrešiti ljude koji su unutar kompetencija Vlade, osim ljudi koji obavljaju zadatke prilikom ostajanja na koju poziciji zbog ostavke ili povrede radnih zadataka.</p>
---	---	--





<p style="text-align: center;"><b>III. STATUSI I ANËTARËVE/EVE TË QEVERISË</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Papajtueshmëria e anëtarëve/eve të Qeverisë</b></p> <p>1. Anëtarët/et e Qeverisë nuk mund të mbajnë asnjë marrëdhënie tjetër pune publike apo private me orar të plotë.</p> <p>2. Anëtarët/et e Qeverisë, me miratimin e Qeverisë, mund të mbajnë disa pozita të nderit, për të cilat nuk paguhen.</p> <p>3. Anëtarët/et e Qeverisë janë të obliguar të shmangin konfliktin e interesit në pajtim me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b> <b>Kodi i Sjelljes të Anëtarëve/eve të Qeverisë</b></p> <p>1. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, anëtarët/et e Qeverisë duhet të sillen në përputhje me standardet më të larta të qeverisjes së mirë dhe legjislacionit në fuqi.</p>	<p style="text-align: center;"><b>III. STATUS OF THE MEMBERS OF THE GOVERNMENT</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Section 9</b> <b>Incompatibility of Government Members</b></p> <p>1. The members of the Government shall not maintain any other full time public or private working relationship.</p> <p>2. The members of the Government may hold some unpaid honorary positions, with Government approval.</p> <p>3. The members of the Government are obligated to avoid any conflict of interest in accordance with the Law for the prevention of conflict of interest during the exercise of public functions.</p> <p style="text-align: center;"><b>Section 10</b> <b>Code of Conduct for Government Members</b></p> <p>1. In the performance of their duties, the members of the Government shall act in accordance with the highest standards of good government and the applicable legislation.</p>	<p style="text-align: center;"><b>III. STATUS ČLANOVA VLADE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Neusaglašenost članova Vlade</b></p> <p>1. Članovi Vlade ne mogu da voditi niti jednu drugu javnu ili privatnu poziciju sa punim radnim vremenom.</p> <p>2. Članovi Vlade mogu voditi nekoliko javnih funkcija delimičnim radnim vremenom ili počasne pozicije, uz saglasnost Vlade.</p> <p>3. Članovi/ce Vlade su obavezni da izbegavaju konfliktima interesa shodno Zakona za sprečavanje konflikta interesa na obavljanju javnih funkcija.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 10</b> <b>Kodeks Ponašanja članova Vlade</b></p> <p>1. Tokom obavljanja svojih zadataka, članovi Vlade treba da se ponašaju shodno najvišim standardima ličnog i ustavnog ponašanja.</p>
---	---	---



2. Çdo anëtar/e i/e Qeverisë duhet t'i përmbahet Kodit të Sjelljes të Anëtarëve/eve të Qeverisë, i cili nxirret nga Qeveria në afat prej gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 11**  
**Imuniteti i anëtarëve/eve të Qeverisë**

Heqja dhe përfundimi i imunitetit të anëtarëve/eve të Qeverisë bëhet në pajtim me ligjin në fuqi për imunitetin.

**IV. KOMPETENCAT E QEVERISË**

**Neni 12**  
**Kompetencat dhe funksionimi i Qeverisë**

1. Qeveria ushtron pushtetin e vet ekzekutiv në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.
2. Përveç kompetencave të përcaktuara në nenin 93 të Kushtetutës, Qeveria është përgjegjëse edhe që të:

2.1. vendosë për emërimet dhe shkarkimet brenda kompetencave të

2. Government members shall comply with the Code of Conduct for Government Members, which shall be issued by the Government within six (6) month after the entry into force of the present law.

**Section 11**  
**Immunity of Government Members**

The waiver and end of the immunity of members of the Government shall be made in accordance with the applicable law on immunity.

**IV. COMPETENCIES OF THE GOVERNMENT**

**Section 12**  
**Competencies and Functioning of the Government**

1. The government exercises its executive powers in accordance with the Constitution and the law.
2. In addition to the competencies specified in Article 93 of the Constitution, the government is also responsible to:

2.1. decide on appointments and dismissals within its competence;

2. Svaki član Vlade treba da se pridržava Kodeksa ponašanja za članove Vlade, koji se donosi od strane Vlade u roku od šest (6) meseci nakon stupanja na snagu ovog zakona.

**Član 11**  
**Imunitet članova Vlade**

Skidanje ili svršetak imuniteta članova/ca sa Vlade izvršise u skladu zakona na snazi o imunitetu.

**IV. OVLAŠĆENJA VLADE**

**Član 12**  
**Ovlašćenja i funkcionisanje Vlade**

1. Vlada sprovodi obavlja svoju izvršnu vlast u skladu sa zakonom.
2. Osim odredjenih nadležnosti u skladu sa članom 93 ustava Vlada je odgovorna i da:

2.1 odlučuje o imenovanjima i razrešenju unutar svojih nadležnosti.



<p>veta;</p> <p>2.2. diskutojë probleme ose çështje të tjera që ajo i konsideron të rëndësishme në kuadër të kompetencave të veta;</p> <p>2.3. shqyrtojë, të debatojë dhe të paraqesë mendimin e saj për projektligjet dhe ndryshimet në ligjet ekzistuese të përgatitura nga Kuvendi apo nga institucionet e tjera, që Qeveria nuk i ka propozuar vetë.</p> <p>2.4. zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet ministrave/eve;</p> <p>2.5. të kërkojë nga secili ministër/e të ekzaminojë çështje të caktuara apo të kryejë detyra të caktuara, si dhe përgatitjen e raportit për këto çështje.</p> <p>3. Në ushtrimin e përgjegjësive të saja, Qeveria mes tjerash, mund të:</p> <p>3.1. marrë vendime me propozimin e Kryeministrit/res ose ministrit/es përkatës/se;</p> <p>3.2. shqyrtojë, debatojë dhe vendos edhe për çështjet në vijim:</p> <p>3.2.1. propozime për akte primare ligjore;</p> <p>3.2.2. propozime për akte</p>	<p>2.2. discuss problems or other issues it considers important within the scope of its competencies;</p> <p>2.3. review, debate and present its opinion on draft laws and amendments to existing laws prepared by the Assembly or other institutions, which the Government has not itself proposed.</p> <p>2.4. resolve disputes between ministers;</p> <p>2.5. require any minister to examine specific issues or conduct specific tasks, and prepare a report on such issues.</p> <p>3. In the exercise of its responsibilities, the government may, inter alia:</p> <p>3.1. make decisions upon the proposal of the Prime Minister or concerned Minister;</p> <p>3.2. review, debate and decide on the following:</p> <p>3.2.1 proposals for primary legislation;</p> <p>3.2.2 proposals for secondary</p>	<p>2.2 Raspravljaju pitanja ili druga pitanja koje ona smatra kao najvažnih u okviru svojih nadležnosti.</p> <p>2.3 Razmatra, raspravlja i predstavlja svoje mišljenje o Nacrtzakonima i izmene u postojećim zakonima pripremljene od strane Skupštine ili ostalih institucija koje Vlada nije sama predlagala.</p> <p>2.4 Rešava nesporazume između ministara/ke;</p> <p>2.5 Da zahteva od svakog ministra da ekzaminira određena pitanja ili da obavlja određene zadatke, kao i priprema iveršaj za ista pitanja</p> <p>3 Na obavljanju svojih odgovornosti Vlada između ostalih može da :</p> <p>3.1 donose odluke predlogom Premijera ili dotičnog ministra</p> <p>3.2 razmatra, raspravlja i odlučuje i o sledećim pitanjima:</p> <p>3.2.1 predloge za primarni zakonski akat,</p> <p>3.2.2. predloge za podzakonskih</p>
---	--	--



<p>nënligjore; 3.2.3. propozime për politika/vendime;</p> <p>3.2.4. të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me bashkëpunimin dhe marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare, pjesëmarrjen në proceset e integritit dhe bashkëpunimit rajonal e ndërkombëtar, si dhe propozimet për lidhjen e marrëveshjeve në këta lëmenj, që janë brenda kompetencave të Qeverisë;</p> <p>3.2.5. dokumente lidhur me çështje të kompetencave të veta, për të cilat i propozon Kuvendit të marrë qëndrim;</p> <p>3.2.6. udhëzime për punën e Qeverisë dhe të ministrive;</p> <p>3.2.7. raportin vjetor për punën e vet mbi zbatimin e politikave, ligjeve, rregulloreve dhe të akteve të përgjithshme, të cilat ia paraqet Kuvendit;</p> <p>3.2.8. qëndrimin e vet për nismat</p>	<p>legislation; 3.2.3 proposals for policies/decisions;</p> <p>3.2.4 all issues related to cooperation and relations with international organizations, participation in integration processes and regional and international cooperation, as well as proposals for conclusion of agreements in these areas, that are within the scope of Government competencies;</p> <p>3.2.5 documents relating to issues within its own competencies, which it proposes that the Assembly take a position on them,</p> <p>3.2.6 instructions for the work of the Government and the ministries;</p> <p>3.2.7 the annual report on its work on the implementation of policies, laws, other regulations and general acts which it submits to the Assembly;</p> <p>3.2.8. its position on initiatives and</p>	<p>akata 3.2.3. predloge za politike –na odluke</p> <p>3.2.4 svako pitanje koje se odnosi na saradnju i na medjunarodnim odnosima , učestvuje na procesu integrisanja i saradnje u rejonu i medjunarodnom području kao i predloge o vezi sa odnosima u ovim oblastima, koje su unutar kompetencija Vlade.</p> <p>3.2.5 dokumenta u vezi sa svojim ovlašćenjima, koje predloži Skupštini da zauzme svoj stav;</p> <p>3.2.6 uputva o radu Vlade i ministarstava;</p> <p>3.2.7 godišnji izveštaj o svom radu i periodični izveštaji o sprovođenju politika, zakona, uredbi i opštih akata, koje predloži Skupština;</p> <p>3.2.8. svoj stav za iniciranje i</p>
--	---	--



<p>dhe propozimet nga Kuvendi ose nga deputetët për çështje brenda kompetencave të veta;</p> <p>3.2.9. aktet ligjore dhe shpjegimet e tyre, rezolutat dhe vendimet e tyre të domosdoshme;</p> <p>3.2.10. propozime për vendosje në raste të caktuara;</p> <p>3.2.11. propozime për informata dhe dokumente të tjera.</p> <p>4. Anëtarët/et e Qeverisë:</p> <p>4.1. mbështesin punën e Qeverisë;</p> <p>4.2. kanë të drejtë të ngrenë iniciativë për përgatitjen e projektligjeve si dhe të propozojnë politika, që kanë të bëjnë me ministrinë e tyre përkatëse.</p> <p>4.3. që janë të caktuar të marrin pjesë në punën e organeve dhe të komisioneve të tjera, janë të detyruar të veprojnë sipas autorizimeve, objektivave dhe qëndrimeve të Qeverisë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.</p>	<p>proposals by the Assembly or by deputies on matters within its competencies,</p> <p>3.2.9. legal acts and their compulsory explanation, resolutions and decisions;</p> <p>3.2.10 proposals for decision of particular cases;</p> <p>3.2.11 proposals for information and other documents.</p> <p>4. Members of the Government:</p> <p>4.1. support the work of the Government;</p> <p>4.2 have the right to lodge initiatives for the preparation of draft laws and propose policies relating to their relevant ministry.</p> <p>4.3 that are assigned to participate in the work of other bodies and committees are obligated to act in accordance with the authorization, objectives and positions of the Government and in accordance to the Constitution and the law.</p>	<p>predloge od strane Skupštine ili od poslanika o pitanjima unutar svojih ovlašćenja;</p> <p>3.2.9. zakonske akte i njihova tumačenja, rezolucije i njihove neophodne odluke.</p> <p>3.2.10 o predlozima za određene slučajeve,</p> <p>3.2.11 o informativnim predlozima, i ostalim dokumentima</p> <p>4. Članovi Vlade:</p> <p>4.1 prisustvuju radu Vlade;</p> <p>4.2 imaju pravo da pokrenu inicijativu o pripremi narta zakona kao i da predložu politike koje se odnose na njihova odgovorajuća ministarstva.</p> <p>4.3 kome je određeno da prisustvuje radu organa i ostalim komisijama, obavezani su da deluje prema ovlašćenjima, ciljevima i stavovima Vlade u skladu sa Ustavom i zakonom.</p>
--	--	---



5. Organizimi i Qeverisë, i ministrive, i ministrave pa portofol, duke përfshirë edhe njësitë vartëse të tyre, do të përcaktohen me Rregulloren për Organizimin dhe Strukturimin e Qeverisë.

6. Fushat e përgjegjësisë administrative të ministrive përcaktohen me rregulloren e nxjerrë nga Qeveria për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.

#### **V. KOMPETENCAT E KRYEMINISTRIT/ES**

##### **Neni 13**

##### **Kompetencat e Kryeministrit/es**

1. Përveç kompetencave të përcaktuara në nenin 94 të Kushtetutës, Kryeministri/ja:

1.1. në emër të Qeverisë, koncepton, propozon dhe zbaton drejtimit kryesorë të politikës shtetërore dhe përgjigjet për to;

1.2. bashkërendon dhe kontrollon punën e anëtarëve/eve të Qeverisë;

5. The organization of the Government, ministries, ministers without portfolio and their subordinate units shall be determined in the Regulation on the Organization and Structure of the Government.

6. Responsibilities and functions for each Ministry shall be set out in the regulation on the areas of administrative responsibility of the office of the prime minister and ministries.

#### **V. COMPETENCIES OF THE PRIME MINISTER**

##### **Section 13**

##### **Competencies of the Prime Minister**

1. In addition to the competencies specified in Article 94 of the Constitution, the Prime Minister shall:

1.1. on behalf of the Government, conceive, propose and implement the principal directions of state policy and is responsible for them;

1.2. coordinate and control the work of the members of the Government;

5. Organizovanje Vlade, ministarstva, ministra bez portofola, obuhvativši i njihove zavisne jedinice, odredjujuse Uredbom za Organizovanje i Strukturiranje Vlade.

6. Oblasti administrativnih odgovornosti ministarstava utvrđuju se Pravilnikom o administrativnim odgovornostima Kancelarije Premijera i ministarstva koji donosi Vlada.

#### **V. OVLAŠĆENJA PREMIJERA**

##### **Član 13**

##### **Ovlašćenja Premijera**

1. Osim nadležnosti koji su određeni članom 94 Ustava, Premijer:

1.1 u ime Vlade, konceptira, predlaže i sprovede glavne pravce državne politike i odgovara na to;

1.2. koordinira i kontroliše poslove članova Vlade;



<p>2. Në zbatim të kompetencave të tij/saj, Kryeministri/ja, mund:</p> <p>2.1. të nxjerr vendime, urdhra, rregullore dhe lidh marrëveshje mirëkuptimi;</p> <p>2.2. të kërkojë nga çdonjëri prej ministrave/eve t'i raportojë me gojë apo me shkrim për punën e tij/saj dhe të ministrisë të cilën e kryeson, që t'i ofrojë informata dhe raporte nga fusha e vet e punës si dhe informata të tjera me rëndësi për mbarëvajtjen e punës së Qeverisë;</p> <p>2.3. menjëherë, ose jo më vonë se në mbledhjen e ardhshme të Qeverisë, të kërkojë që Qeveria ta rishqyrtojë dhe ta ndryshojë vendimin e saj, nëse Kryeministri/ja vlerëson se vendimi i marrë nga Qeveria mund të ketë pasoja të dëmshme. Zbatimi i këtij vendimi pezullohet derisa Qeveria ta trajtojë kërkesën e Kryeministrit/res;</p> <p>2.4. të kërkojë shpjegime dhe verifikime administrative, prej ministrave/eve përgjegjës për çështje të fushës që ata/ato mbulojnë;</p>	<p>2. in the exercise of his/her competencies, the Prime Minister may:</p> <p>2.1 issues decisions, orders, regulations and concludes memorandums of understanding;</p> <p>2.2. require from any minister to report to him/her verbally or in writing on his/her work and on the work of the ministry which he/she heads, and provide him/her with information and reports on his/her area of work and other information important for the running of the Government;</p> <p>2.3. immediately or no later than at the next Government meeting, request the Government to reconsider and amend its decision, if the Prime Minister concludes that a decision adopted by the Government may have damaging consequences. The implementation of such a decision is delayed until the Government addresses the Prime Minister's request;</p> <p>2.4. request for explanations and administrative verifications from The concerned ministers on their relevant fields;</p>	<p>3. Premijer, u sprovođenju svojih ovlašćenja, može:</p> <p>2.1 donositi odluke, naredbe, uredbe i sklapa sporazum;</p> <p>2.2. da zahteva od svakog ministra da podnese pisani izveštaj o svom radu i o radu ministarstva koje predstavlja, da podnese informacije i izveštaje iz svoje oblasti kao i druge značajne informacije o delokrugu rada Vlade;</p> <p>2.3. odmah ili najkasnije do sledećoj sednici Vlade, da traži od Vlade da razmotri i izmeni svoju odluku, ako Premijer oceni da doneta odluka od strane Vlade može imati štetne posledice. Stupanje na snagu ove odluke, odlaze se dok Vlada, razmotri zahtev Premijera;</p> <p>2.4 traži od odgovornih ministara objašnjenja i administrative verifikacije o pitanjima koja oni pokrivaju;</p>
--	--	--



<p>2.5. t'i raportojë Kuvendit në mënyrë periodike, ndërsa me kërkesë të Kuvendit, të raportojë për aktivitetet e Qeverisë apo të ministrisë së caktuar, duke përfshirë shfrytëzimin e të gjitha fondeve të pranuar;</p> <p>2.6. të sigurojë se ka komunikim efektiv të politikave dhe të aktiviteteve qeveritare për qytetarët e Republikës së Kosovës.</p> <p>2.7. të marrë përsipër, me miratimin e Qeverisë, edhe detyra të tjera, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin.</p> <p>2.8. të nënshkruajë të gjitha aktet juridike të aprovuara nga Qeveria dhe mbikëqyr zbatimin e tyre.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b> <b>Kompetencat e zëvendëskryeministrit/es (ave/eve)</b></p> <p>1. Zëvendëskryeministri/ja(at/et), gjatë ushtrimit të funksioneve:</p> <p>1.1. ndihmojnë Kryeministrin/en në caktimin e prioriteteve, në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të Qeverisë;</p>	<p>2.5. periodically report to the Assembly, and upon request by the Assembly, report on the activities of the Government or a specific Ministry, including the use of all funds received;</p> <p>2.6. ensure the effective communication of government policies and activities to the citizens of the Republic of Kosovo;</p> <p>2.7. undertake, with the approval of the Government, other duties, in accordance with the Constitution and the law.</p> <p>2.8. sign all legal acts approved by the Government and supervise their implementation.</p> <p style="text-align: center;"><b>Section 14</b> <b>Competencies of Deputy Prime Minister(s)</b></p> <p>1. In the exercise of their functions, the Deputy Prime Minister(s):</p> <p>1.1. assist the Prime Minister in the prioritization, development and implementation of the Government's</p>	<p>2.5. izveštava Skupštinu periodično, dok na zahtev Skupštine, izveštava o aktivnostima Vlade ili određenog Ministarstva, uključujući i iskorišćavanje svih primljenih fondova.</p> <p>2.6. Premijer obezbedjuje efektivno komuniciranje politika i vladinih aktivnosti za građane Republike Kosova.</p> <p>2.7. Usvajanjem od strane Vlade, Premijer može preuzeti na sebe i druge zadatke u skladu sa Ustavom i Zakonom.</p> <p>2.8 potpisuje sve pravne akte usvojene od Vlade i nadgleda njihovo sprovođenje.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 14</b> <b>Ovlašćenja zamenika/ci premijera</b></p> <p>1. Zamenik/ci premijera, tokom obavljanja funkcija:</p> <p>1.1.pomažu Premijeru u određivanju prioriteta, razvoju i sprovođenju politika Vlade;</p>
--	---	--





<p>1.2. me autorizim të Kryeministrit/es marrin pjesë në hartimin e vendimeve dhe të akteve të tjera, që rregullojnë aktivitetet e Kabinetit të Kryeministrit/es dhe të Qeverisë;</p> <p>1.3. në bashkërendim me Kryeministrin/en i/e mbikëqyrin aktivitetet e organeve operative të Qeverisë dhe sigurojnë zbatimin e përgjegjësive dhe të funksioneve të cilat u janë besuar organeve të tilla;</p> <p>1.4. zëvendësojnë Kryeministrin/en në rast të mungesës;</p> <p>1.5. ushtrojnë detyra të tjera, të cilat u caktohen nga Kryeministri/ja;</p> <p>1.6. zëvendëskryeministri/ja(at/et), me autorizim të Kryeministrit/es, mund të marrin përgjegjësi që i janë dhënë Kryeministrit/es me këtë ligj;</p> <p>1.7. kryejnë detyra të tjera që parashikohen me ligje të veçanta.</p>	<p>policies;</p> <p>1.2. with the authorization of the Prime Minister, participate in the preparation of decisions and other acts regulating the activities of the Prime Ministers Cabinet and the Government;</p> <p>1.3. supervise in coordination with the Prime Minister activities of operational bodies of the Government and ensure that responsibilities and functions entrusted to such bodies are implemented.</p> <p>1.4. deputize for the Prime Minister in his/her absence;</p> <p>1.5. perform other duties assigned to them by the Prime Minister;</p> <p>1.6. with the authorization of the Prime Minister, the deputy prime minister(s), may undertake responsibilities assigned to the Prime Minister under the present law.</p> <p>1.7. perform other duties specified in special laws;</p>	<p>1.2. učestvuju u sastavljanu odluka i drugih akata, koji regulišu aktivnosti Kabineta Premijera i Vlade;</p> <p>1.3. uz koordinaciju sa Premijerom nadgledaju aktivnosti operativnih organa Vlade i obezbeđuju sprovođenje odgovornosti i funkcija koje su takvim organima poverene;</p> <p>1.4. zamenjuju Premijera u slučaju odsutnosti;</p> <p>1.5. obavljaju i druge zadatke koji im se odrede od Premijera;</p> <p>1.6. zamenik/ci premijera, ovlašćenjem od strane Premijera, mogu preuzeti odgovornost koje je Premijeru dato ovim zakonom.</p> <p>1.7. obavljaju i druge poslove, koji su previdjeni posebnim zakonima.</p>
---	--	--



<b>VI. KOMPETENCAT E MINISTRAVE/EVE</b>	<b>VI. COMPETENCIES OF MINISTERS</b>	<b>VI. POGLAVLJE NADLEŽNOSTI MINISTARA</b>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 15</b> <b>Kompetencat e ministrave/eve</b></p> <p>1. Secili ministër/re, në pajtim me direktivat dhe politikat e përcaktuara nga Qeveria:</p> <p>1.1. udhëheq dhe përfaqëson ministrinë;</p> <p>1.2. i përgjigjet Kryeministrit/es dhe Kuvendit për çështjet që kanë të bëjnë me ministrinë e tij/saj;</p> <p>1.3. propozon projektligje nga fushëveprimi i ministrisë dhe përcakton orientimin politik të punës së ministrisë;</p> <p>1.4. nxjerr vendime dhe udhëzime administrative dhe mund të lidhë marrëveshje mirëkuptimi, në mënyrë që t'i rregullojë aktivitetet e ministrisë në përgjithësi ose në fushat e veçanta të ministrisë përkatëse dhe</p> <p>1.5. kryen detyra të tjera në suaza të kornizës së përgjegjësisive të ministries,</p>	<p style="text-align: center;"><b>Section 15</b> <b>Competencies of Ministers</b></p> <p>1. Each Minister shall, in accordance with directives and policies set by the Government:</p> <p>1.1. Lead and represent his/her Ministry;</p> <p>1.2. Be accountable to the Prime Minister and the Assembly for matters concerning his/her Ministry;</p> <p>1.3. propose draft laws from the ministry's area of activity and set the political direction for the work of the Ministry;</p> <p>1.4. Issue decisions and administrative instructions and may conclude memorandums of understanding in order to regulate the activities of the Ministry in general or its particular fields of activity; and</p> <p>1.5. Carry out other tasks within the framework of the Ministry's</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 15</b> <b>Nadležnosti ministra</b></p> <p>1. Svaki ministar, shodno određenim politikama od strane Vlade:</p> <p>1.1. rukovodi i zastupa ministarstvo;</p> <p>1.2. odgovara Premijeru o pitanjima koja se odnose na njegovo ili njeno ministarstvo;</p> <p>1.3. određuje političku orijentaciju rada ministarstva;</p> <p>1.4. donosi odluke i administrativja upustva, sporazume i na taj namin sredjuje vrsnih opštih aktivnosti ministarstva ili u posebnim oblastima dotičnih ministarstva</p> <p>1.5. obavlja i druge poslove u okvirima odgovornosti ministarstva određenih</p>



të përcaktuara me këtë ligj dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.

**Neni 16**  
**Përgjegjësitë e ministrave/eve**

1. Gjatë kryerjes së përgjegjësiave dhe funksioneve të tyre, ministrat/et kujdesen që ministritë e tyre përkatëse:

1.1. të hartojnë dhe të mbikëqyrin zbatimin e politikave të ministrisë;

1.2. të planifikojnë qartë buxhetin dhe të formulojnë prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i vihen në dispozicion nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;

1.3. të sigurojnë ndarjen më të përshtatshme, transparente dhe të përgjegjshme të fondeve që i marrin nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;

1.4. të sigurojnë shërbime të besueshme, transparente, të përgjegjshme dhe jodiskriminuese;

1.5. të krijojnë dhe të zbatojnë masa

responsibilities as determined by the present law and other applicable legislation.

**Section 16**  
**Responsibilities of Ministers**

1. In carrying out their responsibilities and functions, Ministers shall ensure that their respective Ministries:

1.1. Draft and supervise the implementation of ministry policies;

1.2. Plan clearly the budget and formulate priorities for the allocation of funds made available from the Budget of Kosovo and other sources;

1.3 Ensure the most appropriate, transparent and accountable allocation of funds received from the Budget of Kosovo and other sources;

1.4. Ensure the provision of reliable, transparent, accountable and non discriminatory services;

1.5. Establish and implement anti-

zakonom.

**Član 16**  
**Odgovornosti ministara**

1. Tokom obavljanje odgovornosti i svojih funkcija, ministri se staraju da njihova dotična ministarstva:

1.1. da da sastavljaju i nadgledaju sprovođenje politika ministarstva.

1.2 da jasno planiraju budžeta i da formulišu prioritete o raspodeli finansijskih sredstava koja im stoje na raspolaganju od strane Kosovskog budžeta i od ostalih izvora;

1.3. da obezbede odgovorajuću, transparentnu i odgovornu raspodelu fondova koje dobijaju od Kosovskog Budžeta i ostalih izvora;

1.4. da obezbede pouzdane, transparentne i odgovorne usluge, bez diskriminacije;

1.5. da stvaraju i sprovede mere protiv



kundër mashtrimit dhe korrupsionit, si dhe të nxisin vetëdijesimin kundër mashtrimit;

1.6 të krijojnë dhe të aftësojnë kuadro në fushat e përgjegjësi të tyre përkatëse.

**Neni 17**  
**Detyrimet e ministrave/eve**

1. Ministrat/et janë të detyruar:

1.1. të marrin pjesë në mbledhjet e Qeverisë e të trupave të saja të punës, aty ku janë anëtarë/e;

1.2. të informojnë paraprakisht Kryeministrin/en për vizitat jashtë vendit dhe të raportojnë me shkrim, jo më vonë se pesë ditë pas realizimit të tyre;

1.3. të njoftojnë paraprakisht Kryeministrin/en dhe Qeverinë për çdo nismë të ministrive për marrëveshje ndërkombëtare apo të brendshme, organizime të ngjarjeve të rëndësishme e të ngjashme dhe të raportojnë me shkrim, jo më vonë se pesë ditë pas mbarimit të tyre;

1.4. të sigurojnë se politikat ministrore

fraud and anti-corruption measures, as well as promote general fraud awareness;

1.6. Develop human resources and capacity building in the respective areas of responsibility;

**Section 17**  
**Obligations of Ministers**

1. Ministers are obligated to:

1.1 participate in meetings of the Government and its working bodies in which they serve as members;

1.2 inform and obtain the consent of the Prime Minister in advance for their abroad visits and submit a written report, no later than five days after such visit;

1.3. inform the Prime Minister and the Government in advance for any initiative of ministries concerning any domestic or international agreements, organization of various important and similar events and submit a written report, no later than five days after the event is concluded.

1.4. ensure that ministry policies are

prevare i korupcije i da podstiču svesnost protiv prevare;

1.6. da stvaraju i osposobe kadrove u oblastima svojih dotičnih odgovornosti;

**Član 17**  
**Obaveze ministra**

1. Ministri su dužni:

1.1 da prisustvuju sednicama Vlade i njenim radnim telima, tamo gde su članovi;

1.2 da prethodno obaveste Premijera i Vladu o posetama u inostranstvu i da pismeno obaveste, najkasnije pet dana nakon njene realizacije;

1.3 da prethodno obavesti Premijera i Vladu o bilo kojoj inicijativi ministarstava o medjunarodnim ili unutrašnjim sporazumima, organizovanje značajnih i primamljivih događaja i da pismeno izveste najkasnije pet dana nakon njihovog okončanja;

1.4 da obezbede da se ministarske



<p>janë komunikuar dhe diskutuar qartë dhe efektivisht për ata për të cilët janë synuar apo kanë interes në to;</p> <p>1.5. t'i raportojnë Kryeministrit/es dhe Qeverisë në mënyrë periodike, ndërsa me kërkesë të Kryeministrit/es, të raportojnë për aktivitetet e ministrisë, duke përfshirë shfrytëzimin e të gjitha burimeve të pranuar;</p> <p>1.6. të njoftojnë Qeverinë për të gjitha aktet juridike të nxjerra dhe për marrëveshjet e mirëkuptimit të nënshkruara.</p> <p>2. Ministrat/et, përveç kompetencave ose detyrave të përcaktuara më Kushtetutë dhe me ligje të veçanta, ushtrojnë edhe detyra të tjera, me të cilat ngarkohen nga Qeveria ose nga Kryeministri.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 18</b> <b>Të drejtat e ministrave/eve</b></p> <p>1. Ministrat/et kanë të drejtë: 1.1. të iniciojnë nisma për përgatitjen e politikave ministrore, të projektligjeve, të projektudhëzimeve administrative, të projektregulloreve dhe të akteve të</p>	<p>effectively and clearly discussed with and communicated to target groups or interested parties;</p> <p>1.5 report to the Prime Minister and the Government periodically, and at the request of the Prime Minister, report on the activities of the ministry, including the use of all resources received.</p> <p>1.6 inform the Government on all legal acts issued and memorandums of understanding signed.</p> <p>2. In addition to the competencies and duties specified in the Constitution and special Laws, ministers shall also perform other duties assigned to them by the Government or the Prime Minister.</p> <p style="text-align: center;"><b>Section 18</b> <b>Rights of Ministers</b></p> <p>1. Ministers shall have the right: 1.1. to lodge initiatives for the preparation of ministry policies, draft laws, draft administrative instructions, draft regulations and general acts;</p>	<p>politike jasno i efektivno prenesu onima kojima su namenjene ili koji imaju interesa u njima;</p> <p>1.5 periodično izveštava Premijera, dok na zahtev Premijera izveštava o aktivnostima ministarsva uključujući korišćenje svih primljenih fondova.</p> <p>1.6 da obaveštava Vladu o svim donešenim pravnim aktima i potpisanim sporazumima razumevanja.</p> <p>2. Ministri, osim nadležnosti ili zadataka koji su predviđeni Ustavom i posebnim zakonima, obavljaju i druge poslove, kojima su zaduženi od Vlade ili Premijera.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 18</b> <b>Prava ministara</b></p> <p>1. Ministri imaju prava da zahtevaju: 1.1. da iniciraju polazišta o pripremi ministarskih politika, Nacrta zakona, Nacrta administrativnih uputstava, Nacrta uredbi i opštih akata;</p>
--	---	---



përgjithshme;

1.2. t'i raportojnë Qeverisë për problemet në fushën në të cilën ata janë përgjegjës;

1.3. të kërkojnë diskutime dhe zgjidhje për çështje të veçanta në kompetenca të Qeverisë;

1.4. të iniciojnë dhe t'i propozojnë Qeverisë që të nxjerrë rregullore dhe akte të tjera juridike për punën e ministrive.

**Neni 19**  
**Ministrat/et pa portofol**

1. Ministrat/et pa portofol janë anëtarët e Qeverisë të cilët udhëheqin fusha të caktuara të politikës qeveritare të identifikuar si prioritete, pa qenë në krye të një portofoli klasik ministror. Ata vendosen pranë Kryeministrit dhe asistohen nga struktura të cilat i takojnë Zyrës së Kryeministrit.

2. Dispozitat e ligjit, të cilat kanë të bëjnë me mandatin dhe statusin e ministrave/eve, do të zbatohen në mënyrë analoge edhe për

1.2. to report to the Government on problems in the area for which they are responsible;

1.3. to demand discussion and resolution on individual issues within the competencies of the Government;

1.4. to initiate and propose to the Government the issuing of regulations and other legal acts for the work of the ministries.

**Section 19**  
**Ministers without portfolio**

1. Ministers without portfolio are members of the Government that head specific areas of Government policy designated as priority by the Government. Ministers without portfolio do not have a classic ministerial portfolio. They are situated near the Prime Minister and are assisted by OPM structures.

2. The provisions of the law dealing with the mandate and status of ministers shall apply analogously to ministers without

1.2. da izveštavaju Vladu o problemima u oblasti u kojoj su oni odgovorni;

1.3. da zahtevaju rasprave i rešenja o posebnim pitanjima iz nadležnosti Vlade.

1.4. da iniciraju i predlažu Vladi donošenje pravilnika i ostalih pravnih akata o radu ministarstava.

**Član 19**  
**Ministri bez portfelja**

1. Ministri/arke bez portofola su članovi Vlade koji rukovode odredjene oblasti politike Vlade koja su identifikovane sa prioriteto, mada nisu načelni u jednom klasičnom ministarskom portofolu. Oni stoje pored Premijera i asistirani su od struktura koja pripadaju Kancelariji Premijera.

2. Odredbe zakona, koje se odnose na mandat i status ministara/ki, sprovođiće se analogno i za Ministri/arke bez portofola.



ministrat/et pa portofol.

**Neni 20**  
**Kompetencat e zëvendësministrit/es**

1. Zëvendësministrat/et mund të emërohen për mbështetjen e ministrave/eve. Ata/ato janë përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve në fushat e përcaktuara nga ministri/ja përkatës/e, si dhe për zëvendësimin e ministrit/es kur ai mungon ose kur nuk është në gjendje të kryejë detyrën e tij/saj.

2. Me rastin e emërimit të zëvendësministrave/eve duhet të merret parasysh Neni 96, Paragrafi 4 i Kushtetutës.

